



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE/PRANIMIN NË SHËRBIM CIVIL NË KATEGORINË
EKZEKUTIVE

Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/Financë”

niveli minimal i diplomës “Master Profesional”

Specialist, në Sektorin e Financës dhe Buxhetit në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin

• 1 (një) **Specialist, në Sektorin e Financës dhe Buxhetit në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve** – Kategoria III-b

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakat, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kriteret e posaçme dhe të përgjithshme të listuara në shpallje.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJE PARALELE: 26.06.2023

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 29.06.2023

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Hartimi i listë pagesave të punonjësve sipas organikës, ndalesat për sigurimet shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat sipas dispozitave përkatëse.
- Përpilimi i librit të pagave të punonjësve të AMA-s dhe reflektimin e të gjithë ndryshimeve që ndodhin gjatë vitit në bazë të urdhërave ose shkresave të ardhura nga titullarët apo Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe e Arshiv-Protokollit të AMA-s.
- Deklarimi i kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në sistemin e-tax albania brenda afateve ligjore dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për pagesat e raporteve të paaftësis afatshkurtër për punonjësit e AMA-s.
- Rregjistrimi dhe kontabilizimi i dokumentave të magazinës në bazë të situacioneve mujore.

- Kuadrimi i veprimeve me magazinën çdo muaj në baze të kartelave dyfishë.
- Mbajtja dhe regjistrimi në librin e arkës veprimet e kryera konform dokumentacionit përkatës për aktivitetin e brendshëm financiar të institucionit.
- Rregjistrimi dhe rakordimi i inventarit analitik të materialeve për çdo punonjës sipas dispozitave përkatëse.
- Ndjek dhe raporton mbi realizimin e shërbimeve dhe furnizimin me mallra, sipas kontratave të lidhura nga AMA.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

I.1- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-b);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në Shkenca Ekonomike/Financë. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Të ketë mbi 2 vite eksperiencë pune në nivel ekzekutiv;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Njohje të programeve Alfa dhe Financa 5

I.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim për vendim e punës që aplikon;
 - b) Jetëshkrim;
 - c) Fotokopje të diplomës;
 - ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
 - dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
 - gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 26.06.2023.

I.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas dates 26.06.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

I.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

I.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për eksperiencat (20 pike), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi bazën ligjore të sipërcituar;
- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

I.6- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II – Për kandidatet që aplikojnë nga jashtë sistemit të shërbimit civil

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë kandidatet jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për plotësimin e vendit të lirë.

II.1-Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Profesional” për Shkenca Ekonomike/Financë. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Të ketë mbi 2 vite eksperiencë pune të mëparshme në profesion.

II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim për vendim e punës që aplikon;
- b) Jetëshkrim;
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;

II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 29.06.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

II.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë

II.6- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Autoritetit dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë.